

BARKODI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
 MINISTRIA E ARSIMIT
 DHE SPORTIT
 QENDRA E SHËRBIMEVE ARSIMORE

MODEL TESTI I MATURËS SHTETËRORE PROFESIONALE 2025

KUALIFIKIMI PROFESIONAL “MEKANIKË”

Udhëzime për maturantin/kandidatin

Testi përmban gjithsej 60 pikë.

Koha për zhvillimin e pyetjeve të testit është 2 orë e 30 minuta.

Testi ka 20 pyetje me zgjedhje (alternativa) dhe pyetjet e tjera janë me zhvillim.

Pikët për secilën pyetje janë dhënë përbri saj.

Për përdorim nga komisioni i vlerësimit

Kërkesa	1	2	3	4	5	6	7	8
Pikët								
Kërkesa	9	10	11	12	13	14	15	16
Pikët								
Kërkesa	17	18	19	20	21	22	23	24
Pikët								
Kërkesa	25	26	27	28	29	30		
Pikët								

Totali i pikëve

KOMISIONI I VLERËSIMIT

1.....Anëtar

2.....Anëtar

1. Tensioni i brendshëm në një material kur vepron një ngarkesë e jashtme, matet me njësinë matëse: **1 pikë**
- A) N / sek;
 - B) Kg / m;
 - C) N / m²;
 - D) N x m;
2. Indikator i është instrument matës me precizion: **1 pikë**
- A) 0,01 mm;
 - B) 0,02 mm;
 - C) 0,05 mm;
 - D) 0,10 mm;
3. Tunxhi është lidhja metalike e: **1 pikë**
- A) bakrit me aluminin;
 - B) bakrit me kobaltin;
 - C) bakrit me plumbin;
 - D) bakrit me zinkun;
4. Kushineta rrokullisëse me rrula konike mban ngarkesë: **1 pikë**
- A) vetëm radiale;
 - B) vetëm aksiale;
 - C) aksiale dhe radiale;
 - D) radiale dhe traversale;
5. Çimentimi është proces kimiko-termik që realizohet duke ngopur sipërfaqen e detalit metalik me: **1 pikë**
- A) natrium;
 - B) karbon;
 - C) çimento;
 - D) bakër;
6. Raporti i transmesionit të një çifti rrotash të dhëmbëzuara cilindrike llogaritet si: **1 pikë**
- A) raporti midis numrit të dhëmbëve;
 - B) raporti midis diametrave të brendshëm;
 - C) raporti midis diametrave të jashtëm;
 - D) raporti midis diametrave të boshteve;
7. Saldimi me hark i detaleve prej bronzi bëhet me elektroda me përbërje: **1 pikë**
- A) zinku me alumin;
 - B) gize me bakër;
 - C) bronzi me alumin;
 - D) bronzi me çelik;

8. Instrumenti që realizon saktësinë më të madhe të punimit të vrimave është: **1 pikë**
- A) alezatori;
 - B) puntoja;
 - C) kalizvari;
 - D) guri retifikues;
9. Retifikimi është punim: **1 pikë**
- A) fillestar;
 - B) përfundimtar;
 - C) i ashpër;
 - D) gjysëm i ashpër;
10. Saldimi me hark, TIG, është është punim: **1 pikë**
- A) mekanik;
 - B) elektrik;
 - C) kimik;
 - D) termik;
11. Polirimi i detalit përdoret për të rritur: **1 pikë**
- A) fortësinë e sipërfaqes;
 - B) ashpërsinë e sipërfaqes;
 - C) pastërtinë e sipërfaqes;
 - D) elasticitetin e sipërfaqes;
12. Te një shufër mekatlike ku veprojnë ngarkesa ngjeshëse, lindin tensione: **1 pikë**
- A) normale;
 - B) tangenciale;
 - C) përdredhëse;
 - D) përkulëse;
13. Nëse një çift rrotash me dhëmbë të pjerrët transmeton moment përdredhës të vogël, kushinetat ku mbështeten boshtet përkatëse duhet të jenë: **1 pikë**
- A) me gjilpëra;
 - B) me rrula cilindrikë;
 - C) me rrula konikë;
 - D) me sfera;
14. Dhëmbi i një rrote me dhëmbë cilindrikë punon: **1 pikë**
- A) në përkulje;
 - B) në shtypje lokale;
 - C) të dyja të mësipërmet;
 - D) asnjë nga të mësipërmet;

15. Në vizatimet e punës së detaleve, njësia matëse që vendoset në përmasat nominale është: **1 pikë**
- A) decimetri;
 - B) centimetri;
 - C) milimetri;
 - D) mikrometri;
16. Në vizatimin e punës së detalit tregohen: **1 pikë**
- A) makinat ku do punohet;
 - B) instrumentet prerëse që do përdoren;
 - C) tolerancat gjeometrike;
 - D) shtesat e punimeve;
17. Kushineta me rrula konikë mban ngarkesa: **1 pikë**
- A) vetëm aksiale;
 - B) vetëm radiale;
 - C) vetëm tangenciale;
 - D) vetëm radiale - aksiale;
18. Në rastin e bashkimit të dy pllakave metalike me bulona, buloni punon në: **1 pikë**
- A) tërheqje;
 - B) shtypje;
 - C) përdredhje;
 - D) përkulje;
19. Dendësia e metalit është veti: **1 pikë**
- A) kimike;
 - B) mekanike;
 - C) teknologjike;
 - D) fizike;
20. Kur një shufër metalike punon në prerje, tensionet që lindin janë: **1 pikë**
- A) paralel me seksionin tërthor;
 - B) tangjent me seksionin gjatësor;
 - C) paralel me seksionin gjatësor;
 - D) pingul me seksionin tërthor;

Për pohimet e mëposhtme, rretho **PO**, për përgjigjen e saktë dhe **JO**, për përgjigjen e gabuar:

- 21.** Për transmetimin e lëvizjes midis dy akseve të kithëta, duhet të përdoren: **4 pikë**
- | | | |
|--|----|----|
| a) rrota cilindrike me dhëmbë të drejtë | PO | JO |
| b) rrota cilindrike me dhëmbë të pjerrët | PO | JO |
| c) rrota me dhëmbë të hipoidale | PO | JO |
| d) rrotë shoqe me burmë pa fund | PO | JO |
- 22.** Vrima e filetuar, e dëmtuar, në trupin e një detali, riparohet me anë të: **4 pikë**
- | | | |
|--------------------------------------|----|----|
| a) mbushjes, rishpimit dhe filetimit | PO | JO |
| b) shkëndijës elektrike | PO | JO |
| c) zëvendësimit të një pjese | PO | JO |
| d) kromimit | PO | JO |
- 23.** Nëse dëmtohet pompa e vajit të makinës tornuese, atëhere detalet e kësaj makine: **4 pikë**
- | | | |
|---------------|----|----|
| a) shformohen | PO | JO |
| b) mbinxehen | PO | JO |
| c) thyhen | PO | JO |
| d) oksidohen | PO | JO |
- 24.** Një bosht kryen lëvizje rrotulluese nëse: **4 pikë**
- | | | |
|--|----|----|
| a) shuma e momenteve që veprojnë është e ndryshme nga zero | PO | JO |
| b) shuma e forcave që veprojnë është e ndryshme nga zero | PO | JO |
| c) shuma e forcave dhe momenteve që veprojnë është zero | PO | JO |
| d) diferenca e momenteve që veprojnë është e ndryshme nga zero | PO | JO |
- 25.** Gjatë tornimit të një boshti çeliku: **4 pikë**
- | | | |
|--|----|----|
| a) punimi i ashpër kryhet më mirë me numër të lartë rrotullimesh | PO | JO |
| b) punimi i pastër kryhet më mirë me thellësi punimi të vogël | PO | JO |
| c) saktësia e punimit rritet kur boshti është i gjatë | PO | JO |
| d) pastërtia e sipërfaqes rritet kur zvogëlohet hapi i punimit | PO | JO |
- 26.** Shkruani 4 nga llojet e transmisioneve mekanike: **4 pikë**
- a) _____
- b) _____
- c) _____
- d) _____

27. Shkruani 4 instrumenta prerës që përdoren për punimin e vrimave:

4 pikë

- a) _____
- b) _____
- c) _____
- d) _____

28. Për procesin e saldimit me gaz, plotësoni vendet bosh në fjalinë e mëposhtme:

4 pikë

- a) Kur materiali mbushës është i njëjtë me materialin _____, cilësia e saldimit është _____
- b) Për të shmangur oksidimin në zonën e _____ të saldimit, mjedisi i saldimit mbrohet me anë të _____

29. Emërtoni 4 pjesët kryesore të kushinetës rrokullisëse të figurës së mëposhtme:


4 pikë

- 1. _____
- 2. _____
- 3. _____
- 4. _____



30. Për secilën nga katër figurat e mëposhtme, emërtoni llojin e punimit:

4 pikë



- 1. _____
- 2. _____
- 3. _____
- 4. _____

